

VENDIM
Nr. 25, datë 28.2.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KESH” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç”, dhe nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, neni 4, pika 1, germa “d”; neni 5, pika 1, germa “d”, neni 13, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të *“Rregullores për Organizimit Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

Kostatoi se:

- Me Vendimin e Bordit nr. 4, datë 17.1.2019, ERE ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- Me shkresat nr. 5/2 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 5/7 prot., datë 13.2.2019, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për informacion, lidhur me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nisur nga parashikimi i pikës 3, germa “b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE, me shkresën nr. 32/1 prot., datë 18.1.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure.
- Nuk rezulton të ketë ardhur asnjë koment nga palët.
- Nuk rezulton të ketë ardhur asnjë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me këtë kërkim.

ERE shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a. dhe, nga sa depozituar në ERE me këtë kërkesë rezulton si më poshtë.

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7.1, gjerat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi